



Republika e Kosovës
Kuvendi Komunal Malishevë

PRANUAR MË:

03/10/2022

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

04/450



Duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.2, nenin 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019"), nenit 13, 14, 19, 20 dhe 21 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, me qëllim të zbatimit të Vendimit paraprak të Kuvendit Komunal Nr.02/359, datë 11/08/2022 për Inicimin e Procedurave për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë (15-99 vite) të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Komisioni Komunal për Vlerësimin e Ofertave i formuar sipas Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.02/360, në takimin e mbajtur me datë 30/09/2022, mori vendim që të shpallë:

NJOFTIM PUBLIK PËR SHPREHJEN E INTERESIT

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99 vite) të pronës së paluajtshme të komunës

Në bazë të Vendimit paraprak të Kuvendit Komunal Nr.02/359, datë 11/08/2022, Komisioni Komunal për Vlerësimin e Ofertave përmes këtij njoftimi publik ju bënë ftesë të gjithë të interesuarve, personave fizik dhe juridik që të shfrytëzojnë mundësinë e marrjes në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vjet, pronën e paluajtshme të komunës të përshkruar si më poshtë:

Parcela kadastrale për dhënien në shfrytëzim:

- Parcela Nr.P – 72310025-00223-525, me sipërfaqe prej 20000 m², (2 hektar) Zona Kadastrale Dragobil, Komuna e Malishevës.
- Prona gjendet në pjesën e ashtuquajtur Pallanka – Golesh, afër rrugës së Transitit të qytetit që është në realizim e sipër, konkretisht mbrapa Lagjes Mirdita.

Kriteret për përzgjedhjen e ofertave:

- Vlera e investimit (vlerësohet nga 1-5 pikë);
- Numri i të punësuarve (vlerësohet 1-5 pikë);
- Lloji i investimit i cili është me interes publik dhe me prioritet për komunën (vlerësohet nga 1-10 pikë);

Çmimi fillestar i qirasë vjetore për shfrytëzimin e pronës komunale është 2 €(dy euro).

Kriteret e përgjithshme për të interesuarit në pjesëmarrje në shprehjen e interesit:

1. Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës është 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite;
2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim është ndërtimi i "Qendrës për persona me nevoja të veçanta" në nivel të Republikës së Kosovës;
3. Të drejtë pjesëmarrje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik të cilat janë të regjistruara sipas ligje të Republikës së Kosovës;

4. Personat fizik dhe juridik të cilët marrin pjesë, ofertës duhet bashkangjitur:
 - a) Certifikata e regjistrimit me të gjitha informacionet që dëshmojnë së personi juridik është i regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës;
 - b) Planin e biznesit;
 - c) Projektin ideor dhe planin dinamik të investimit;
 - d) Vërtetimin e tatimit në pronë;
 - e) Vërtetimin nga ATK-ja që nuk ka obligime ndaj shtetit;
 - f) Fotokopja e dokumnetit valid të identifikimit – leternjoftimin.

Kohëzgjatja e e shpalljës së njoftimit publik për shprehjen e interesit për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë do të jetë 15 (pesëmbdhjetë) ditë nga dita e publikimit në web-faqen e Komunës, në tabelen e shpalljeve dhe në mediat lokale, elektronike dhe të shkruara. Ofertat dorëzohen të mbyllura në pliko, nëpërmjet Qendrës për Shërbim me Qytetar, Zyra e Pritjes, Objekti i ri i Komunes, Kati përdhësë, deri me datën 18/10/2022 në ora 16:00.

Në anën e jashtme të plikos duhet të shënohen të dhënat e aplikuesit si dhe Për: Komunën e Malishevës, Shprehja e Interesit, Prona në Zonen Kadastrale Dragobil.

Vendi dhe koha ku do të bëhet hapja e ofertave

Hapja e ofertave do të bëhet në Sallën e Kuvendit Komunal (Objekti i vjetër i komunës, kati i parë) me datë 21/10/2022, duke filluar nga ora 10:00, ku ofertat do të bëhen publike duke siguruar qasje të drejtëpërdrejtë për të gjithë pjesëmarrësit.

Prona e cila është objekt i këtij njoftimi publik nuk mund të përdoret për qëllime tjera përveç qëllimit të cekur në këtë njoftim dhe vendimit të Kuvendit Komunal. E njëjta nuk mund të bartet tek personat e tretë ose të jepet me qira. Nga momenti i nënshkrimit të kontratës mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës, shfrytëzuesi i fiton të gjitha të drejtat mbi shfrytëzimin e qetë të asaj prone por gjithashtu obligohet që t'i paguaj të gjitha detyrimet që dalin nga nënshkrimi i kontratës.

Pjesëmarrësve në konkurim i'u garantohet e drejta që të informohen lidhur me procedurat e shprehjes së interesit, të vizitojnë (shohin) pronën që do të jepet në shfrytëzim nga momenti i shpalljës publike të njoftimit.

Pjesëmarrësit në konkurim kanë të drejtë të tërhiqen nga konkurimi jo më vonë se tri ditë para ditës kur do të bëhet hapja e ofertave. Në qoftë se fituesi i ankandit tërhiqet para nënshkrimit të kontratës të gjitha procedurat do të anulohen dhe njoftimi për shprehje të interesit të tërhiqet.

Raporti i vlerësimit të ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës:

- Komisioni vlerësues brenda 3 (tri) ditë punë pas mbylljës së njoftimit publik për shprehje të interesit, bënë hapjen dhe vlerësimin e ofertave në vendin dhe kohën e përcaktuar me lartë. Pas vlerësimit të ofertave Komisioni Vlerësues harton raportin përfundimtar dhe përzgjedh ofertën me të favorshem;
- Njoftimi për ofertën e përzgjedhur i dërgohet fituesit dhe vendoset në tabelën e shpalljeve publike dhe në web – faqen zyrtare të komunës;
- Palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese ndaj përzgjedhjes që ka bërë Komisioni Komunal për Vlerësimin e Ofertave në afat prej shtatë (7) ditësh;

- Komisioni i Ankesave shqyrton ankesaat brenda dhjetë (10) ditësh dhe nëse konstaton se ka pasur shkelje gjatë procesit të vlerësimit kërkon rishqyrtimin e ofertave;
- Nëse Komisioni i Ankesave vlerëson ankesat si të pabazuara, atëherë Komisioni Vlerësues i Ofertave raportin e vlerësimit të ofertave se bashku me ofertën fituese ia drejton Kuvendit Komunal për miratim përfundimtar;
- Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit të raportit nga Komisioni Vlerësues dhe ofertën e rekomnduar miraton vendimin përfundimtar për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë dhe e autorizon kryetarin e komunës që në afatin brenda dhjetë (10) ditë punë nga hyrja në fuqi e vendimit përfundimtar të kuvendit të nënshkruaj kontratën me fituesin.

Vërejtje: Aplikacionet për konkurrim mund të mërren në Qendrën për Shërbime me Qytetar ose në formë elektronike përmes web-faqes së Komunës së Malishevës.

Malishevë 03/10/2022

Komisioni Komunal për Vlerësimin e Ofertave
Kryesuesi i Komisionit - Bashkim Krasniqi

E-mail: bashkim.k.krasniqi@ks-gov.net





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës
Nr. 02/ 359
Datë: 11.08.2022

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 dhe 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/15, qershor 2008”, mbështetur në nenin 4,5, nenin 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 8 paragrafi 1 pika 1.1,1.2, nenin 14 paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10/03, Prill 2019”, në bazë të nenit 5 paragrafi 1, pika 1.3, nenit 8,9,10, të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës, në bazë të nenit 10, nenit 19, nenit 46, Statutit të Komunës së Malishevës Nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 09.08.2022 merr këtë:

V E N D I M
PËR INICIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË
PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Miratohet propozimi Nr.01/1223 i datës: 09.08.2022 i parashtruar nga kryetari i Komunës, për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, përmes shprehjes së interesit, për ndërtimin e “Qendrës për persona me nevoja të veçanta” në nivel të Republikës së Kosovës.
2. Prona e paluajtshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, e cekur si në pikën 1 të këtij vendimi është në Z.K Dragobil në vendin e quajtur “Palanka-Golesh” e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-72310025-00223-525, në sipërfaqe të përgjithshme prej 20000m² me kulturë kullosë e klasës 5, në emër të Komunës së Malishevës.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike përmes shprehjes së interesit është ngase në të njëjtin lokacion, Komuna planifikon të ndërtojë “Qendrën për persona me nevoja të veçanta” në nivel të Republikës së Kosovës.
4. Obligohet Komisioni për vlerësimin e ofertave që në pajtim me nenin 15 dhe nenit 19 paragrafi 3, të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren (QRK) Nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës, t’i kryejnë procedurat e njoftimit publik për dhënie në shfrytëzim afatgjatë dhe pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave e procedon në Kuvendin e Komunës për aprovim ofertën e përzgjedhur.
5. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës caktohet të jetë afatgjatë për nëntëdhjetë e nëntë (99) vite, ndërsa çmimi minimal i qirasë për shfrytëzimit të lokacionit të lartcekur do të jetë në shumën prej 2€ (dy euro) qira vjetore.

6. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.

7. Mënyra e shfrytëzimit dhe menaxhimit të lokacionit të përcaktuar me këtë vendim, do të rregullohet sipas procedurave të parapara ligjore.

8. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunës, përmes organeve tjera kompetente.

9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
MAPL-së
Drejtorive të KK-së.





CERTIFIKATË / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72310025-00223-525

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 06-486-2022
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 29.07.2022 - 16:05
Komuna / Opština / Municipality: MALISHEVË / MALIŠEVO / MALIŠEVĚ
Zona Kadastrale / Katastrarska Zona / Cadastal Zone: Dragobil / Dragobilje / Dragobil
Zyra Kadastrale Komonale / Opštinska Katastrarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office: MALISHEVË / MALIŠEVO / MALIŠEVĚ

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastrarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R GIS U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72310025-00223-525	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena imovina / Socially owned Land	Urban	20000		29.07.2022	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place PALANKA-GOLESH	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On 29.07.2022	Azhuruar Ažurirano Updated
----------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------	---------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------	----------------------------------

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kullosar/Pashnjac/pasture	Kullosë E Klases 5/Pashnjak 5 Klasse/5th Class Pasture	20000

B. PRONARI/POSEDEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësi e adresës Pojednostil adresa Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuaruar Azurirano Updated
Posedim individual/ Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Malishevës	600535259	/ / /			1/1	Aktivndim Nr.01-302 dt.16.02.2012	29.07.2022




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office : MALISHEVE
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone : Dragobil

Njësia/Jedinica/Unit	Tip/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m ²
P-72310025-00223-525	Parcelë / Parcela / Parcel	20000



Shkalla/Razmera/Scale 1:1479

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 29.07.2022

Koha/ Vreme/ Time: 04:06:57

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënimi/Belaška/Note:

Approvot/Usvojeno/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

